

čitrn, qytetet e Nishit dhe Beogradit, përfaqësuesit e të cilëve kanë marrë pjesë në prezantimet publike të *Libër Kujtimet të Kosovës, Viti 1998*, që janë organizuar me qëllim konfirmimin e të dhënave të mbledhura.

Në Serbi, ndihmën e pakursyer na kanë dhënë Shoqata e Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Vrarë në Kosovë e Metohi, si dhe Shoqata e Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë e Metohi. Na kanë dhënë të gjitha të dhënat me të cilat disponojnë si dhe kontaktet me familjet, të cilat janë bërë bashkëpunëtorë aktiv në mbledhjen e të dhënave. I vetmi institucion në Serbi që na ka dhënë ndihmë është Ministria e Mbrojtjes. Në Mal të Zi, së bashku me hulumtuesit tanë në terren dhe nga familja në familje, ka shkuar kryetari i Shoqatës së Familjeve të Vrarëve, të Zhdukurve dhe Rrëmbyerve 1998 - 1999 në Territorin e Kosovës e Metohisë, *Bozhuri i Kuq/Crveni božur*. Të gjitha familjeve u kemi borxh një falënderim të përzemërt.

Roli im

Detyra ime ka qenë që ta lexoja çdo regjistrim, që ta krahasoja atë me deklaratat e dëshmitarëve dhe burimet tjera, të intervenoj në përshkrimin e fakteve ku kishte nevojë, dhe të lejoi versionin final të regjistrimit dhe tabelës, apo ta kthej për kontrollin shtesë të të dhënave.

Përkrahja financiare

Hulumtimet dhe botimin e *Libër Kujtimet të Kosovës, Viti 1998* e kanë ndihmuar Komisioni Evropian, Fehmi Agani Association, French Catholic Committee Against Hunger and for Development (CCFD), Civil Rights Defenders, Kosovo Foundation for Open Society (KFOS), National Endowment for Democracy (NED), US Institute of Peace (USIP), USAID (përmes Academy for Educational Development - AED), IKV Pax Christi, Qeveria e Mbretërisë së Holandës, si dhe ambasadat e RF Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe në Beograd.

Gabimet e mundshme

Emrat e njerëzve i kemi kontrolluar mijëra herë. Nëse ka gabime, atëherë ato janë përvjedhur dhe kanë ndodhur pa dashje. I lusim familjarët dhe miqtë e njerëzve për të cilët flasim në këtë libër që të kenë mirëkuptim. Regjistri individual me emër dhe mbiemër i njerëzve që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur me dhunë në luftërat ballkanike gjatë viteve të nëntëdhjeta është një punë prej pionieri që hedh hapat e parë në një fushë të panjohur. Nuk ka shembull të tillë në historinë tonë të re. *Libër Kujtimi i Kosovës, viti 1998* do të vendoset në Internet, qasja ndaj tij do të jetë e lehtësuar dhe ai do të jetë i hapur për korrigjime dhe informacione të reja, me një qëllim të vetëm që: *Njerëzit t'i Kujtojnë Njerëzit*.

